VENDIM
Nr.503, datë 13.5.2009

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET, QË OFROHEN NGA AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 "Për nënshkrimin elektronik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shërbimet, që ofrohen nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri
Sali Berisha

Tarifat që zbatohen nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik

Lloji i shërbimit	**Vlera e tarifës**	**Periodiciteti i tarifës**
Regjistrim i ofruesit të sh]ërbimit të certifikimit	20 000 lekë	Njëvjeçar
Regjistrim i organizimit të testimit e konfirmimit	20 000 lekë	Njëvjeçar
Vlerësim periodik	10 000 lekë	Njëvjeçar